

## FONDI SOVRAN I GARANCISË, 1 MILIARD LEKË PËR BUJQËSINË



Në mbështetje të bujqësisë, Qeveria shqiptare ka vendosur të alokojë 1 miliard lekë në bankat e nivelit të dytë si Fond Sovran Garancie nga shteti për të financuar 50% të kolateralit për kredi në bujqësi. Fondi u drejtohet operatorëve të cilët janë duke planifikuar një investim në prodhimin e produkteve bujqësore dhe ato të lidhura me ekonominë blu, në ndërtimin e një serre të re apo të sistemeve të lidhura me të, në rritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së paketimit të prodhimeve vendase, në sistemet e ujitjes me pika në parcelat e tyre, në përpunimin e produkteve dhe konsolidimin në tregje dhe në raftet e supermarkatave në mënyrë që produktet shqiptare të mos jenë produkte gjenerike, por produkte të seleksionuara, përpunuara dhe të paketuara për konsumatorin final. Kjo mbështetje vjen si një mundësi jo vetëm për ata të cilët janë operatorë të afirmuar të sektorit, por edhe për ata të cilët janë individë me iniciativë dhe ide novatore dhe që e shohin të ardhmen e tyre në bujqësi, në sektorin e përpunimit apo dhe marketimit.



### SHËRBIMI NDAJ FERMERIT

#### PÛRKRAH FERMERËVE, AREB DHE AKVMB NË TERREN MES NGRICAVE

Muaji janar është karakterizuar nga temperatura të ftohta dhe Minsitria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka publikuar këshillat dhe masat që duhen marrë për mbrojtjen e kulturave bujqësore dhe kafshëve të fermave. Përkrah fermerëve, fshat më fshat dhe fermë më fermë, nga Korça në Blinisht, Dajç, Kallmet, Fushë-Mamurras, Lezhë, Kafaraj, Belsh, Mollas, Fushë-Krujë, Cërrik, Drithas, Maliq, Suç, Klos, Burrel, Dajç, Librazhd, Devoll, Ibi, Vreshtas, veterinerët zyrtarë të Agjencisë Kombëtare të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, si edhe specialistët e Agjencive Rurale të Ekstensionit Bujqësor kanë ndihmuar fermerët e blegtorët të përballojnë problemet me motin.



### MBËSHTETJA PËR ZHVILLIM

#### FINANCIMI PËR TURIZMIN RURAL DHE EKSPORTE NË RITJE

Thirrja IV e programit IPARD II, me financimet nga BE dhe Qeveria shqiptare për Turizëm Rural dhe Zejtari u hap me një buxhet prej 5,2 milionë euro. Në përpjekje drejt anëtarësimit të BE dhe në një frymë të ngjashme bashkëpunimi, u ndërtua marrëveshja Open Balkan me Serbinë e Maqedoninë e Veriut. Një synim i marrëveshjes është rritja e eksporteve shqiptare. Ministria Krifca ishte me këtë qëllim në panairin "Agro Belgrade" me 14 biznese shqiptare. Eksportet bujqësore në tërësi përgjatë vitit 2021 u rritën në vlerë prej 15.6% krahasuar me vitin 2020.

### SIGURIA USHQIMORE

#### AKU, BORD I RITHEMELUAR DHE QASJE E RE INSTITUCIONALE

Bordi i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit u rithemelua me përfaqësues nga shkenca, shoqatat e konsumatorëve, agrobiznesit, bashkive, etj, për të mundësuar transparencë absolute me publikun. AKU do të ketë një qasje krejt të re institucionale. Për garantimin e sigurisë ushqimore si prioritet i prioritetëve, AKU ka shtuar kontrollet, drejtoritë rajonale po asistohen nga përfaqësues të projektit të sigurisë ushqimore "The Food Safety Project", si dhe është vendosur një numër i gjelbër (08007575), ku në bashkëpunim me qytetarët dhe denoncimet e tyre ka pasur sukses në frenimin e disa shkeljeve që cenonin sigurinë e konsumatorit.

### FËMIJËT NË BUJQËSI

#### SI VIJNË USHQIMET E SHËNDETSHME NË TAVOLINË?

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka nisur një angazhim të përmuajshëm me fëmijët, për t'i njohur me bujqësinë, për t'i mësuar të ushqehen shëndetshëm, e për të nisur një edukim të hershëm mbi vlerën e punës dhe prodhimet e fermerëve. Me fëmijët e qendrës komunitare "Të qëndrojmë së bashku" në Tiranë, ministria vizitoi një fermë pranë kryeqytetit, ku u kujdesën për kafshët, mbollën qepë dhe shëtitën me traktor, duke u kthyer për një ditë në "fermerë shembullorë". Nëse flasim për fermerë shembullorë, për këtë muaj është Qani Malaj, nga Llakatundi i Vlorës, ku prej tre dekadash punon pa pushim në fermë dhe me punë sot ka 500 krerë bagëti.

### TEKNOLOGJI DHE INOVACION

#### RIKTHEHEN DOKTORATURAT NË UBT, TEKNOLOGJI PËR BUJQËSINË

Pas tetë vitesh, në UBT rihapet programi i doktoraturave. 30 studentë ekselentë do të studiojnë në universitetet më të mira europiane, me financim të qeverisë gjermane. E ardhmja e bujqësisë shqiptare është bujqësia e dijës, e aplikimit të të rejave shkencore dhe inovacionit teknologjik. Me këtë vizion të qartë, ministria Frida Krifca ka takuar Arbër Bamllari, një matematikan i ri, i kthyer nga studimet në Angli, që ka ngritur kompaninë e tij teknologjike në Shqipëri fokusuar në përdorimin e dronëve në shërbim të bujqësisë, me analizimin e tokës dhe bimëve nga kamerat multispektrale.